



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:156378
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05464947

Ac.nr.9976/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B. M. nga fshati H., Komuna e Kamenicës, të cilën me autorizim e përfaqëson I. R., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGURIA”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson kompania e avokatëve “Arbëresh”, rr. “Brigada 153”, “D. R.”, Hajvali, Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur lidhur me ankesat e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.103/2018 datë 06.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themelta ankesat e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.103/2018 datë 06.07.2021, në pikën I, II dhe IV, VËRTETOHET.

Pika III e dispozitivit të aktgjykimit Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.103/2018 datë 06.07.2021, mbeten të pa shqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.103/2018 datë 06.07.2021, ka vendosur: I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B. M. nga fshati H., Komuna e Kamenicës dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 07.03.2017, t’ia paguaj paditëses shumat si në vijim:

- Në emër të dëmit jomaterial:
- Për dhimbjet e përjetuara fizike – trupore, shumën prej.....3.500.00 (tremijë e pesqind) euro,
- Për friken e përjetuar, shumën prej.....2.000.00 (dymijë) euro,
- Për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shkallë prej 15.78 %, shumën prej.....5.000.00 (pesëmijë) euro,
- Për shëmtim trupor shumën prej.....2.500.00 (dymijë e pesqind) euro.
- Në emër të dëmit material:
- Për ndihmën dhe përkujdesjen nga personi i tretë, shumën prej.....150.00 (njëqind e Pesëdhjetë) euro.
- Për ushqim të përforcuar shumën prej.....150.00 (njëqind e pesëdhjetë) euro.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” me seli në Prishtinë, që t’ia paguaj shumat e gjuara paditëses si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 13.300.00 (trembëdhjetëmijë e treqind) euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi e deri në pagesës definitive, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses B.M., në shumë prej 9.300.00 (nëntëmijë e treqind) euro, shumë kjo përtej shumës së gjuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe pjesa tjetër e kërkesëpadisë me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 07.03.2017, në emër të rehabilitimit fizioterapeutik - klimatik, t’ia paguaj shumën prej 600.00 euro, SI TËRËSISHT E PABAZUAR.

IV. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” me seli në Prishtinë, që brenda afatit prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë, në shumën të përgjithshme prej 1.689.60 (njëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë cent) nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, ndërsa shuma tjetër prej 104.00 (njëqind e katër) euro, e kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës, përtej kësaj të gjuar, refuzohet si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura, Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin a ankimuar dhe lëndën ta kthen në gjykatën e shkallë së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Përgjigje në ankesë është parashtruar nga paditësi, duke propozuar që të refuzohet ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, si dhe shikimin, analizimin dhe vlerësimin shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja B. M. nga fshati H..., Komuna e Kamenicës, me datën 03.07.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensim dëmit material dhe jo material, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Siguria" me seli në Prishtinë, i cili kërkesë, me parashtresën e datës 27.04.2021, ka bërë precizimin e kërkesë padisë, duke kërkuar konkretisht si në parashtresën e dorëzuar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.103/2018 të datës 06.07.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e ankimuar ka arsyetuar se: Duke i marrë parasysh provat materiale të administruara, si dhe dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata ka ardhur në përfundim se paditësja B. M. me datën 07.03.2016, rreth orës 17:55 min., në magjistralen Gjilan - Kamenicë, ka pësuar lëndime të rënda trupore si pasojë e aksidentit të komunikacionit të shkaktuar nga i pandehuri (i siguruari i të paditurës) Q. B., i cili derisa ishte duke e drejtuar autobusin për transport të udhëtarëve të markës "M. N." me tabela të regjistrimit 06-520-BI, pronë e N.T.P "A.. C...", nga pakujdesia ka shkelur Ligjin mbi Sigurimin e Komunikacionit Rrugor, përkatësisht duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të komunikacionit rrugor dhe kushteve atmosferike, me ç' raste më pjesën e parë të anës së djathtë të autobusit e godet këmbësoren, tani paditësen B. M., e cila në atë moment ishte duke trupuar rrugën nga ana e majtë në të djathtë dhe nga kjo goditje e dëmtuara pëson lëndime të rënda trupore e për të cilat detyrohet të kërkojë edhe ndihmën mjekësore në Emergjencën e Spitalit të Gjilanit, e këtë fakt gjykata e vërtetojë në bazë të aktgjykimit P.nr. 487/2016, të datës 06.09.2017, të Gjykatës Themelore në Gjilan.

Më tej ka shtuar, Në bazë të provave materiale të administruara, Gjykata në emër të dhimbjeve fizike - trupore, e ka aprovuar pjesërisht kërkesën e paditëses në shumën prej 3.500.00 (tremijë e pesqind) euro dhe e vlerësojë si një shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësja sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped - traumatolog, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit poasqërisht të rëndë që kanë zgjatur për (1) një orë deri në fillimin e dhënies së ndihmës së parë mjekësore, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë që kanë zgjatur (3) tri ditë, për çka dëshmon terapia e ordinuar kundër dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 45 ditë dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët të cilat janë prezentë dhe tani.

Më tej ka shtuar se: Në emër të frikës së pësuar - përjetuar nga e dëmtuara – paditësja gjykata e ka aprovuar pjesërisht kërkesën dhe ka caktuar shpërblimin në shumën prej 2.000.00 (dymijë) euro, të cilën e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertës mjekësore të psikiatrisë, paditësja ka pësuar frikë primare të manifestuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimit direkt për integritetin e saj trupor që ka zgjatur për disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për 24 orë dhe që është manifestuar me simptoma të ankthit të gjeneralizuar, frikë nga invaliditeti, çrregullim gjumi, rikujtime të shpeshta të ngjarjes dhe simptoma përcjellëse të reagimit akut ndaj stresit, kjo pastaj ka kaluar në frikë sekondare me intensitet mesatar dhe më të ulët e cila ka zgjatur për 3 - 4 (tre deri në katër) muaj, e manifestuar me reagime emocionale të karakterit akcioz, zgjime të herë pas hershme gjatë gjumit me rikujtime të ngjarjes traumatike, e po ashtu paditësja edhe sot e kësaj dite ndien pasiguri gjatë pjesëmarrjes në komunikacion.

Më tej ka shtuar se: Në emër të shëmtimit të pësuar nga paditësja B. M., gjykata pjesërisht e ka aprovuar kërkesën e palës paditëse dhe e ka caktuar shpërblimin në shumën prej 2.500.00 (dymijë e pesëqind) euro, duke e vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se nga ekspertiza mjekësore tek paditësja është prezent shëmtimi trupor në shkallën e mesme, për shkak të defektit – cikatriks postoperator në regjionin ballor majtas me diametër rreth 5 cm., tek e cila po ashtu ecja karakterizohet me çalim në anën e majtë e cila është evidente më tepër gjatë ecjeve shkallëve si dhe terreneve ku i nevojitet sforcim fizik. Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shkallë prej 15.78%, gjykata pjesërisht e ka aprovuar kërkesën e palës paditëse dhe e ka caktuar shpërblimin në shumën prej 5.000.00 (pesëmijë) euro duke e vlerësuar si shpërblim të drejtë, ashtu që i'a fali besimin kostatimit të ekspertit edhe në këtë pjesë andaj, duke konsideruar se shuma e të hollave prej 5.000.00 (pesëmijë) euro, paraqet satisfkacion të drejtë për tejkalimin me më lehtësi të pasojave të kësaj forme të dëmit të shkaktuar.

Më tej ka shtuar se: Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditëses, moshën e saj, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkruar si më lartë, gjykata aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses e në vlerat shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimit, duke e vlerësuar si shpërblim real, objektive dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtushmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit. Andaj, Gjykata konsideron se shumata e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraqesin një satisfaksion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuar të paditëses në aksidentin e komunikacionit të datës 07.03.2017, lëndimet dhe pasojat, duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 200, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktikën e deri tanishme të gjykatave të Kosovës.

Më tej ka shtuar se: Lidhur me shumata e gjykuara për paditësen që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit material në emër të ndihmës dhe përkujdesjes nga personi i tretë në shumën prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) euro gjykata vendosi duke e pasur parasysh konstatimin e ekspertit mjekësor i cili ka konstatuar se paditësja ka pasur nevojë të paktën 30 ditët e para për përkujdesje të plotë për shkak të paaftësisë totale për t'u ngritur nga shtrati ndërsa edhe për 60 ditë të tjera i është nevojitur përkujdesje për nevoja të tjera personale (higjienë, veshmbathje, ushqim etj) dhe ushqimit të përforcuar në shumën prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) euro, duke u bazuar po ashtu

në konstatimin e ekspertit mjekësor i cili ka konstatuar se për paditësen ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 3 muaj, i pasur me albumina, minerale dhe vitamina, dhe i vlerësojë si të pranueshme për nga baza por, jo edhe për nga lartësia e kërkuar nga ana e këtu paditëses andaj, i ka aprovuar pjesërisht kërkesat sa i përket dëmeve të këtij lloji. Gjykata ka vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi sa i përket dëmit material të pësuar nga paditësja, duke marr për bazë praktikën gjyqësore në Republikën e Kosovës. Gjykata e ka marr për bazë kohëzgjatjen e nevojës për ndihmë dhe përkujdesje nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar të konstatuar në ekspertizë mjekësore të ortopedisë dhe traumatologjisë të cekur si më lartë për paditësen, si dhe nga fakti që praktika gjyqësore i njih rastet e tilla të kompensimit. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh fakti se për këto forma të dëmit në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo, pasi që paditësja ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar (të cekur sikurse në ekspertizën e cekur më lartë), të njëjtës ligjërisht i takon ky lloj i kompensimit të dëmit i kërkuar në shumat e gjykuara.

Vendimi mbi kamatën e gjykuar është marrë në kuptim të nenit 382.2 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e gjithashtu nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit aktgjykimi i shkallës së parë, nuk është i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit vlerëson se nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit në lartësinë e përgjegjësisë së të siguruarit të tyre nuk është kontestuar vazhdimisht nga e paditura e që është vërtetuar edhe nga aktgjykimi Penal P.nr. 487/2016 i datës 06.09.2017 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan, si dhe lartësia e kërkesës është vërtetuar nga ekspertizat mjekësore që gjinden në shkresat e lëndës. Gjendjen faktike për dëmin jo material dhe material, për paditësen, gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes mendimit të ekspertit mjeko-ligjor, Dr. L... K., Ortoped - traumatolog dhe Dr. S... B., Psikiatër për të gjitha kategoritë e dëmit jo-material duke u bazuar edhe në vlerësim të

lirë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, mendimet e ekspertëve mjeko-ligjor i ka vlerësuar si profesionale, gjithëpërfshirëse dhe reale, duke pas parasysh natyrën e lëndimit, kohëzgjatjen e dhimbjeve, frikën e përjetuar etj., dhe se kompensimi i dëmit jo-material dhe material në të holla ka për qëllim satisfaksionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi. Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumën e gjykuara sipas kategorive të dëmit si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësore, prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se shumën e aprovuara për dëmin jo materiale dhe material, janë në përputhje edhe me lëndimet e shkaktuara paditëses dhe të njëjtat paraqesin satisfaksion në raport me lëndimet e marra, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre si dhe kohën e nevojshme për shërimin, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 15.78%, lartësinë e shëmtimit truporë e të cilat janë konstatuar edhe nga ekspertizat e ekspertëve mjeko-ligjor, Dr. L. K., Ortoped - traumatolog dhe Dr. S. B., Psikiatër. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin.

Gjykata e Apelit nuk i morri për bazë pretendimet e të paditurës në lidhje me aplikim të gabuar të së drejtës materiale pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur është bazuar në nenin Neni nenit 136.1 të LMD-së, i cili parasheh që *“kush i shkaktonte tjetrit dëmin, ka për detyrë të ia kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, kurse me dispozitën e nenit 159.1 të LMD-së, i cili parasheh që *“në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”* ndërsa sipas nenit 183 par. 1 të LMD-së, për kompensimin e dëmit material dhe jo material si dhe lartësinë e dëmit, i cili parasheh që *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*. Ndërsa në paragrafin 2 të po të njëjtit nen është paraparë që *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Andaj, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitat materialo-juridike të cilave u është referuar e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve, dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, rrethanat tjera, e sidomos moshën e paditëses si dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumën e gjykuara janë në përputhje me qëllimin shoqëror për kompensimin e dëmit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësit, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit.

Përveç kësaj Gjykata e Apelit e mbështet vendimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me kërkesëpadinë e paditëses sa i përket dëmit material për ushqim të përforcuar, dhe ndihmën e personit të tretë, pasi që ky lloj kompensimi i gjykuar sipas aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me rrethanat e tjera të krijuara si dhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se për paditësen ka qenë e nevojshme ushqimi i përforcuar për 3 muaj, ndihma e personit të tretë në kohëzgjatje prej 30 ditë, dëme ky që është i mbështetur edhe në provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës si dhe nevojat e paditëses të përcaktuara nga ekspertët e cekur si më lartë.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 382 të LMD-së.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjykuara nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, pasi që janë veprime të domosdoshme, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësve në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Gjykata e Apelit, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, duke mos e shqyrtuar pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, pasi që për të njëjtin nuk kishte pretendime ankimore.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AC.nr. 9976/2021, me datë 12.03.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari
Besnik Bislimaj, d.v